



REPUBLIKA E SHqipërisë  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

# DITARI MUJOR

## DHJETOR 2023

### Shpallen datat e provimeve të Maturës Shtetërore 2024

DATAT E PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2024	
Gjuhë e huaj	3 qershor
Gjuhë shqipe dhe letërsi	10 qershor
Matematikë	18 qershor
Provimi me zgjedhje	24 qershor
Provimi Teori profesionale e integruar për Maturën Shtetërore Profesionale	24 qershor

### Program i ri përforcimi për nxënësit me mësuesit e dispozicionit

Ministria e Arsimit dhe Sportit do të pilotojë programin e mësuesve të dispozicionit dhe të përforcimit të lëndëve të caktuara për nxënësit, nëpërmjet orëve të posaçme në shkollë, për të rritur nivelin e arritjeve të tyre. Ky program i dyfishtë, i cili do të fillojë në muajin Janar, do të përfshijë 82 mësues të caktuar në 30 shkolla të ndryshme në të gjithë vendin.



### Çertifikohen 240 drejtues dhe aspirantë nga Shkolla e Drejtorëve

Çertifikohen 240 drejtues dhe aspirant, pjesëmarrës të programit të trajnimit për drejtues të shkollave të arsimit parauniversitar, të brezit të pestë të Shkollës së Drejtorëve. Nga fillimi i programit të trajnimit nga Shkolla e Drejtorëve, prej nëntorit të vitit 2019, janë çertifikuar 857 mësues. MAS në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, ka mundur një standard të ri për trajnime dhe çertifikime për mësuesit dhe edukimin e tyre në vazhdim.

### “Mësuesi i vitit 2023”

Në një ceremoni të veçantë të organizuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit janë nderuar mësuesit e vitit, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre të vyer në përgatitjen e brezave të rinj. Në këtë ceremoni janë vlerësuar me çmime 10 mësues dhe dy ekipe nga shkollat e mesme dhe 9-vjeçare.



## Investimet në shkolla



Hap dyert shkolla e re “Lidhja e Prizrenit” në Paskuqan, e rindërtuar me standardet më të mira në bashkinë e Kamzës, e cila sapo i shërben mbi 600 nxënësve dhe mësuesve. Ministria e Arsimit dhe Sportit Ogerta Manastirliu vizitoi gjithashtu edhe gjimnazin “Havzi Nela” në Kukës, i rikonstruktuar tërësisht me financimin e Ministrisë së Arsimit dhe Bashkisë Kukës, si dhe shkollën e mesme “Bajram Abdiu” në Bicaj të Kukësit, e cila është në proces rikonstruksioni me financim të MAS. Me buxhetin 2024 do të përfundojë investimet në 30 shkolla dhe hapen kantieri të reja në institucionet arsimore nga veriu në jug.

### “ZGJIDH ZANATIN”

Falë fushatës promovuese “Zgjidh Zanatin” që u zhvillua prej 2 muajsh në të gjitha shkollat e vendit, përmes bashkëpunimit të zyrave arsimore, gjimnazeve dhe shkollave profesionale, janë orientuar mbi 370 nxënës të klasave të X-ta drejt shkollave profesionale, në drejtimet më të kërkuara nga tregu i punës.



### VLERËSOHEN NXËNËSIT EKSELENTË

Kryeministri Edi Rama dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit Ogerta Manastirliu, kanë vlerësuar me “Medaljen e Artë” 162 maturantë me rezultate të shkëlqyera, në një ceremoni të zhvilluar në ambientet e Kryeministrisë. Gjithashtu në një ceremoni të organizuar nga MAS, janë vlerësuar 55 nxënës fitues të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, pas përfundimit të tre fazave të Olimpiadave Kombëtare për vitin 2023.